



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.744/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me bashkëpunëtorin profesional Malsor Kryeziu, në kontestin e paditësve F. I. dhe N. I., që të dy nga fshati L. e P. Komuna e Prizrenit, të cilët i përfaqëson e autorizuara e tyre av. F. Ç.-K. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve U. G. A. "S." nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 26.08.2013, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësve F. I. dhe N. I., që të dy nga fshati L. e P. Komuna e Prizrenit dhe **detyrohet** e paditura U. G. A. "S." nga Prishtina, që në emër të dëmit material dhe atij jo material, t'ia kompensoj paditësve shumat si në vijim:

Paditësit F. I.:

- për dhimbje fizike (trupore), shumën prej 2000 euro;
- për shëmtim të shkallës së mesme, shumën prej 800 euro;
- për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 12,5%, shumën prej 3000 euro;
- për frikën e përjetuar, shumën prej 1.000 euro, respektivisht shumën e tërësishme prej **6.800 euro**, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar në bankat komerciale, duke e llogaritur atë nga dita e parashtrimit të padisë e deri te pagesa definitive, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Paditëses N. I.:

- për dhimbje fizike (trupore), shumën prej 500 euro;
- për frikën e përjetuar, shumën prej 600 euro, respektivisht shumën e tërësishme prej **1.100 euro**, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar në bankat komerciale, duke e llogaritur atë nga dita e parashtrimit të padisë e deri te pagesa definitive, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

II. Obligohet e paditura, që t'ia paguajë paditësve shpenzimet procedurale dhe atë shumën në lartësi prej **1.444 euro**, në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit F. I. mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, si dhe pjesa e kërkesëpadisë e cila ka të bëjë me shpenzimet në emër të ushqimit të përforcuar, ndihmës së personit të tretë, si dhe për shpenzimet e shërimit banjologjik, **refuzohet si e pabazuar.**

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses N. I. mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, si dhe pjesa e kërkesëpadisë e cila ka të bëjë me shpenzimet në emër të ushqimit të përforcuar, ndihmës së personit të tretë, si dhe shpenzimet e shërimit banjologjik, **refuzohet si e pabazuar.**

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit F. I. dhe N. I., përmes të autorizuarës së tyre av. F. Ç. – K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material, kundër të paditurës U. G. A. “S.” me seli në Prishtinë, duke theksuar se me datën 06.01.2007, në rrugën magjistrale Prizren-Reqan, afër ujësjellësit në Prizren, vozitësi D. I., duke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të “VW 351 Pasat”, me targë të regjistrimit xxx-KS-xxx, duke mos i’u përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës, del nga rruga me ç’rast bjerë në një thellësi prej 15 metrave në lumë. Si pasojë e këtij vetëaksidenti, lëndime trupore pësojnë bashkëudhëtarët F. dhe N. I., përkatësisht këtu paditësit. Vozitësi i automjetit është shpallur fajtor për veprën penale rrezikim i trafikut publik. Të dëmtuarit - këtu paditësit kanë pësuar lëndime, ku për paditësen konstatohen lëndime trupore (ndrydhja e qafës dhe e gjoksit) për çka të njëjtës i është dhënë terapia adekuate dhe është liruar në shtëpi, ndërsa paditësi F. për shkak të lëndimeve serioze, ishte ndalur në spital dhe ka qëndruar aty për dy javë në Pavijonin e Ortopedisë, e për shkak të lëndimeve serioze, ku aty i ishte nënshtruar një operacioni me anestezion të përgjithshëm. Ka theksuar se nga lëndimet e pësuar paditësit kanë pësuar dhimbje fizike, shëmtim, kanë pasur frikë, të njëjtëve i’u është zvogëluar aktiviteti i përgjithshëm jetësor, kanë pasur nevojë për përkujdesjen e huaj dhe ushqim të përforcuar, si dhe për shërim banjologjik. Duke u bazuar në dispozitat e LMD-së, i kanë propozuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin do të aprovohej kërkesëpadia e paditësve F. dhe N. I., si e bazuar dhe do të obligohej e paditura KS “S.” nga Prishtina, që t’ua kompensoj paditësve dëmin jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit në shumën e përgjithshme prej 9.900 euro, me kamatë ligjore duke e llogaritur atë nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, e autorizuar e paditësve av. F. Ç.-K. nga Prizreni, ka deklaruar se mbetet pranë padisë, kërkesëpadisë si dhe parashtrësës mbi precizimin e kërkesëpadisë të datës 16.08.2013, të dhënë pas ekspertizës së ekspertit mjeko-ligjor dr. Xh. S. nga Prishtina, si dhe ekspertizës së ekspertit të psikiatrisë dr. S. Sh. nga Prizreni, ashtu që tani ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura U. G. A. “S.” nga Prishtina, që paditësve t’ua kompensoj dëmin material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 06.01.2007 si në vijim: në emër të dëmit jo material dhe material, paditësit F. I., t’ia kompensojnë shumën e përgjithshme në lartësi prej 10.500 euro, ndërsa në emër të dëmit jo material dhe atij material, paditëses N. I. t’ia kompensojnë shumën e përgjithshme në lartësi prej 2.200 euro, respektivisht që të dyve tua kompensojnë shumën e tërsishme në lartësi prej 13.200 eurove, me kamatë ligjore duke e llogaritur atë që nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, më saktësisht sikurse në parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë të datës

16.08.2013. E autorizuar e paditësve i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 1.444 euro, më saktësisht të specifikuar sikurse në parashtrësën e lartëcekur.

Përmes përgjigjës me shkrim në padi të datës 06.02.2013, e paditura U. G. A. "S." nga Prishtina, e ka kontestuar në tërsi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i të paditurës U. G. A. "S.", A. N. nga Prishtina, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi bazën juridike të padisë dhe të kërkesëpadisë, pasi që duke u bazuar në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve përkatësisht nenet 361, 371, 376 dhe 380, kjo lëndë është parashkruar. Sipas tij, neni 361 thotë se parashkrimi fillon "të rrjedh ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit", neni 371 parasheh se kërkesat parashkruhen për 5 vjet. Neni 376 parasheh se kërkesat e shpërblimit të dëmit të shkaktuara parashkruhen 3 vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe neni 380 ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kontratave të sigurimit, pra ky nen është i veçantë që i abrogon nenet e përgjithshme ku thotë "kërkesat e sigurimeve nga kontratat e sigurimeve parashkruhen për 3 vjet", pasi që kemi të bëjmë me palën e tretë në këtë rast thotë se kërkesat për sigurimet në jetë parashkruhen për 5 vjet, kurse nga kontratat e tjera mbi sigurimin për 3 vjet. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë për përgjigjen në padi shumë prej 101 euro, për tri (3) seanca shumë prej 405 euro, përkatësisht shumë e tërësishme të shpenzimeve në lartësi prej 506 euro.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: aktgjykimi penal i formës së prerë P.nr.836/07, i datës 22.04.2010; raporti mjekësor i Qendrës Emergjente të Spitalit të Prizrenit, me nr. të protokollit 205 të datës 06.01.2007; fletëdalja e Spitalit të Qarkut në Prizren - Pavioni i Ortopedisë me nr. të historisë 576; raportet e specialistit të datës 31.01.2007, 19.02.2007, 02.04.2007, 02.04.2007, si dhe lista terapeutike me numër rendor 14369; leximi i konfirmimit të sigurimit për TPL - mjete motorike të datës 04.06.2010, të lëshuar nga "S."-Prizren; raporti i aksidentit me nr.2007 GR 0069, të datës 06.01.2007; ekspertiza e ekspertit mjeko-ligjor dr. Xh. S. – ortoped - traumatolog nga Prishtina, e datës 10.06.2013; raport - ekspertiza mjekësore e ekspertit psikiatër dr. S. Sh., e datës 12.08.2013, për paditësin F. I.; si dhe raport - ekspertiza mjekësore e ekspertit psikiatër dr. S. Sh., e datës 12.08.2013, për paditësen N. I.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkespadia e paditësëve është pjesërisht e bazuar.

Nga raporti i aksidentit me nr.2007GR0069 të dt.06.01.2007, gjykata ka vërtetuar faktin se me datën 06.01.2007, rreth orës 21,15 minuta në rrugën magjistrale Prizren – Reqan, në afërsi të ujës-jellësit në Prizren, duke mos i'u përmbajtur dispozitave të komunikacionit rrugor, si dhe duke mos i'a përshtatur shpejtësin e levizjës kushteve dhe rethanave në komunikacion, shoferi I. D. rrezikon sigurinë e komunikacionit rrugor në atë mënyrë që me automjetin e udhëtarëve të markës "VW 351 Passat", me targë të

regjistrimit xxx-KS-xxx, gjatë tejkalimit del nga rruga në anën e djathtë dhe bie nga lartësia prej 15 metra në lumë, me ç'rast lëndimi të rënda trupore merr udhëtari F. I., ndërsa udhëtarja tjetër N. I., pëson lëndime të lehta trupore. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti, në momentin e shkaktimit të këtij aksidenti, ka qenë i siguarur tek këtu e paditura.

Në këtë aksident, paditësi F. I. ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe njëjtë i është dhënë ndihma mjekësore, fillimisht në Qendrën Emergjente të Spitalit Rajonal të Prizrenit, për të vazhduar pastaj në repartet përkatëse të po këtij spitali. Në bazë të fletëlëshimeve nga institucionet e lartëcekura, dokumentacionit tjetër mjekësor të cilat kjo gjykatë i ka administruar në cilësi të provave materiale si dhe në bazë të ekzaminimit të drejtëpërdrejtë dhe në prani të gjykatës të paditësit F. I., eksperti mjeko-ligjor dr. Xh. S. – ortoped – traumatolog nga Prishtina, i'a ka parashtruar gjykatës në seancë mendimin e vet, të cilit mendim gjykata i'a fali besimin, duke gjetur - konstatuar se paditësi F. I. në këtë aksident të komunikacionit ka pësuar lëndimet të rënda trupore si thyerje me shumë fragmente, brenda nyjore e pjesës së poshtme të kockës së humerusit (krahut) të djathtë dhe olekranit të parakrahut të njëjtë me dislokim – e operuar. Dhimbjet fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë kanë zgjatur afërsisht 40 minuta (duke e llogaritur momentin e aksidentit, kohën e transportit, procedurat diagnostifikuese deri në fillim të mjekimit). Dhimbjet fizike të intensitetit të rëndë kanë zgjatur 4 ditë (kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes), ndërsa intensiteti i mesëm i dhimbjeve ka zgjatur 28 ditë (koha e nevojshme për fillimin e konsolidimit parësor kockor), përderisa dhimbje fizike të intensitetit të ulët, paditësi ka edhe sot e kësaj dite, por që janë të shprehura gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Shëmtim trupor është prezent në shkallë të mesme (për shkak të vrazës operatore prej 15 cm, në pozicion të dukshëm të krahut të djathtë). Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është i shprehur në shkallën prej 12,5% dhe atë për shkak të kufizimit të lëvizjeve të nyjës së bërrylit të djathtë, të përshkruara si në ekspertizën e ekspertit mjeko-ligjor dr. Xh. S. Ndhma e huaj ka qenë e nevojshme në intervalin kohor prej 42 ditëve. Ushqimi i përforcuar i nevojshëm dhe i begatshëm me proteina, albumina, karbohidrate, vitamina dhe minerale ka qenë i nevojshëm në intervalin kohorë prej 70 ditësh. Trajtimi rehabilitues fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm për tri (3) herë nga dhjetë (10) ditë brenda vitit të parë pas aksidentit dhe 10 ditë të tjera për vitin e dytë pas aksidentit.

Bazuar në mendimin e po këtij eksperti mjekoligjor, paditësja e dytë N. I. në aksidentin në fjalë, ka pësuar lëndimet si në vijim: ndrydhje të qafës dhe të kraharorit, të cilat lëndime karakterizohen si lëndime të lehta trupore. Dhimbja fizike e intensitetit posaçërisht të rëndë ka zgjatur afërsisht 20 min. Dhimbja fizike e intensitetit të rëndë ka zgjatur 24 orë, intensiteti i mesëm i dhimbjeve ka zgjatur 10 ditë, ndërsa dhimbja fizike e intensitetit të ulët ekziston edhe sot e kësaj dite por që shprehet gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Shëmtimi trupor nuk ekziston. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ekziston. Ndhma e huaj ka qenë e nevojshme për 10 ditë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në interval prej 20 ditësh, i begatshëm me proteina, albumina, karbohidrate, vitamina dhe minerale. Trajtimi rehabilitues fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm dhjetë (10) ditë brenda vitit të parë pas aksidentit.

Sipas raportit të ekspertit të psikiatrisë dr. S. Sh., në këtë aksident, paditësi F. I., ka përjetuar frikë primare ekzistenciale të intensitetit shumë të lartë rreth një orë dhe frikë sekondare të intensitetit të lartë 5 ditë, të intensitetit të mesëm 1 muaj dhe të intensitetit të lehtë 4 muaj. I njëjti po ashtu ka përjetuar çrregullime të përshtatjes - sjelle shmangëse -

droja gjatë qarkullimit në rrugë, sidomos në vendkalime, si dhe veshja për shkak të defektit estetik (cikatrikse - vrragë post traumatike dhe post operative).

Po ashtu bazuar në raportin e këtij eksperti të psikiatrisë, paditësja N. I., në këtë aksident ka përjetuar frikë primare eksistenciale të intensitetit të lartë rreth 1 orë dhe frikë sekondare të intensitetit të lehtë 2 muaj. E njëjta po ashtu ka përjetur çrregullime psiçike, sjellje shmangëse - droja gjatë qarkullimit në rrugë, sidomos në vendkalime dhe brenga mbi prognozën e lëndimt të birit.

Në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.836/07, të datës 22.04.2010, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari D. I. nga fshati L. e U., Komuna e Prizrenit, përndryshe ngasësi i automjetit të udhëtarëve “VW 351 Passat”, me të cilin është shkaktuar aksidenti (e i cili ka qenë i siguaruar tek këtu e paditura Kompania e Sigurimeve U. G. A. “S.” nga Prishtina), është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi për veprën penale të rrëzikimit të trafikut publik, të paraparë me nenin 297 par.5 në lidhje me par. 3 të Kodit Penal të Kosovës.

Baza ligjore

Me nenin 154 al.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se **“kush i shkaktonte tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensojë, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”**, ndërsa me nenin 178 të po këtij ligji është paraparë se **“në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar për faj të një poseduesi të automjetit, vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”**. Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se **“në procedurën kontestimore gjykata në pikpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”**.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Në bazë të lartëcekurave gjykata ka vërtetuar se e paditura është përgjegjëse ndaj këtu paditësve konform përgjegjësisë në bazë të fajësisë, të paraparë me dispozitat e lartëcituara të nenit 178 al.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe dispozitave mbi kompenzimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësisë së tyre për dëmin material të shkaktuar, e të parapara me dispozitat e nenit 189 al.2 të LMD-së, si dhe dëmit jomaterial konform nenit 200 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumatat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësve dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarve – këtu paditësve, satisfaksion që ata të jenë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat jomateriale nga të cilat janë privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ata do ta kishin poqëse të njëjtat nuk do t'i kishin humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intenzitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe nevojat e shtuara të ushqimisë, ndërsa për paditësin F. I., gjykata ka marrë parasysh edhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor-fizik në shkallën prej 12.5 %, respektivisht pasojat e lëndimeve më afër të përshkruara si në mendimin e ekspertit mjekoligjor dr. Xh. S. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompenzimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash, gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirave dhe qëllimit të

cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin se me të njëjtin, të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi ngase konsideroi se shumata e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarve të sillet aty ku do të ishte po mos të kishte ndodhur veprimi dëmtues. Mbi bazën e të lartëcekurave, gjykata vlerëson se shumata e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjesisë deliktore civile të të paditurës. Njëherit gjykata e refuzoi pjesën e kërkespadiës së paditësve e cila ka të bëjë me shpenzimet në emër të ushqimit të përforcuar, ndihmës së personit të tretë, si dhe shpenzimet e shërimit banjologjik, ngase gjeti se paditësit me asnjë provë të vetme nuk i kanë argumentuar këto shpenzime.

Gjykata nuk i mori për bazë theksimet e të autorizuarit të paditurës se në këtë rast kemi të bëjmë me vjetërsimin e kërkesës, ngase në rastet kur kemi të bëjmë me lëndime të rënda trupore, të shkaktuara përmes veprës penale nga neni 297 par.5 lidhur me par.3 të Kodit Penal të Kosovës (për të cilën veprë penale është shpallur fajtor shoferi i automjetit me të cilin është shkaktuar aksidenti), parashkrimi absolut i ndjekjes penale është 10 vite. Ndërsa që me nenin 377 al.1 të LMD-së, është paraparë se *“kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë i parashkrimit, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha për parashkrimin e ndjekjes penale”*. Meqenëse aksidenti është shkaktuar në vitin 2007, ndërsa padia për komensimin e dëmit, nga ana e padiësve i është dorëzuar kësaj gjykate në vitin 2012, gjykata vlerëson se në këtë rast nuk ka parashkrim të kërkesës së paditësve.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrur konform nenit 452 të LPK-së dhe tarifës zyrtare për përfaqësime dhe atë për shpenzimet si në vijim: për përpilimin e padisë 104 euro, për përpilimin e parashtresës për precizimin e kërkesëpadiës 104 euro, për shpenzimet e eksperteve shumë prej 400 euro, taksa për padi 50 euro, taksa për aktgjykim 66 euro, për 4 përfaqësime për dy palë, nga 180 euro secila, përkatësisht 720 euro, respektivisht shumë e tërësishme të shpenzimeve në lartësi prej 1.444 euro.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.744/12, datë 26.08.2013

Bashkëpunëtori profesional,
Malsor Kryeziu

Gjyqtari,
Valon Totaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

